



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kaçaniku
Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Nr: 104/02-31159

10.01. 2025

Raport

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës dhe facebook

<chrome-extension://efaidnbmnnnibpcajpcgiclfefindmkaj/https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2024/12/fatlume.pdf>

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

-Me 11.12.2024, është publikuar njoftimi për mbajtjen e takimit publik për : takimin e dytë publik me qytetar për punën e kryetarit të arriturat dhe sfidat 2024, Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, facebookun e komunës.

Rikujtimi i publikuar në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Komentet:

1. **Flakron Tusha-** Ju përgëzoj për punët dhe të arriturat pavarësisht sfidave, unë kam pasur një kërkesë me i ftu përfaqësuesit e Klubit Lepenci dhe me debatunë lidhje me gjendjen e këtij klubi, pse nuk janë ftuar. Poashtu kërkoj që të bëhet digjitalizimi i Shkollës Filllore "Emin Duraku" e veçanërisht me projektor, si dhe kërkoj që të bëhet rregullimi i ndriçimit publik në disa lagje ku është dëmtuar.
2. **Nezir Luta:** Ivajë- Aka fonde emergjente për zhblokim të rrugëve nga bora?
3. **Shabi Dullovi:** Biqec- kam vetëm lëvdata nga fshati Biqec po bëni punë të mrekullueshme, të përfundohet rruga alternative në Biqec.
4. **Xhevdet Hysa:-** Drejtor i Shkollës Filllore " Agim Bajrami"- Ju falënderoj për investimin në shkollën tonë, ndërsa kërkojmë që të futet në listën e investimeve komunale edhe Salla e Edukatës Fizike në Stagovë.
5. **Kemajl Jaha:** Stagovë- Rruga nga Lagjja Teneq e deri në Stagovë ku ka mrri me procedura a planifikohet të fillohet ,me punime?
6. **Rrustem Zenuni:** Kërkoj që të asfaltohet një pjesë e mbetur e rrugës " Razim Hasaj" sepse tashmë është bërë rrugë e rëndësishme, si dhe asfaltimi i rrugëve në lagjen Vogliqi, lagje në dy rrugica si dhe rruga Semajë Gaçkë.

Përmes formës elektronike në emailat e zyrtarëve përgjegjës për pranimin e komenteve, nuk është pranuar asnjë koment në formë elektronike nga ana e qytetarëve, nuk është pranuar asnjë koment as në formë fizike, ndërsa gjatë takimit publik janë pranuar vetëm disa komente.

Përgjigje

- 1- Takimi është organizuar për punën dhe të arriturat e kryetarit gjatë vitit 2024, ndërsa Klubi është i lirë të organizoj debate kur do që e shih te arsyeshme. ShFMU"Emin

Duraku" e ka të instaluar rrjetin adekuat për digjitalizim dhe është planifikuar që në vitin 2026 të jetë shkolla e pare në komunë komplet e digjitalizuar.

2. Komuna e Kaçanikut ka të kontraktuar kompaninë për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale. Kjo kontratë mbulohet nga buxheti për Mallra dhe Shërbime të drejtorisë së shërbimeve publike dhe emergjencave. Fond i veçante për emergjenca nuk ka.
3. Projekti i rrugës alternative te fsh. Biqec do të shqyrtohet të realizohet përmes kontratës "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale" ne planifikimet e vitit 2025-2027.
4. Në ShFMU "Agim Bajrami" nuk kemi planifikuar në një të ardhme të afërt ndërtim të sallës së edukatës fizike.
5. Projekti do të implementohet në vitin 2025 sipas përgjegjësive të cekura në pikën 1 të Nenit 8 të Marrëveshjes për mbështetje financiare të projektit nga Skema e Grandit të Performancës komunale ngase ne vitin 2024 shkak u ankesave te operatoreve ekonomik në OSHP nuk u arrit të lidhet kjo kontratë.
6. Asfaltimi një pjesë e mbetur e rrugës " Razim Hasaj" si dhe asfaltimi i rrugëve në lagjen Vogliqi, lagje në dy rrugica si dhe rruga Semajë Gaqkë do të shqyrtohet te realizohet përmes kontratës "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale" në planifikimet e vitit 2025-2027.

Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:

Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik,

Lista e nënshkrimeve të zyrtarëve komunal si dhe qytetarëve pjesëmarrës në konsultimin publik.

Raporti është përgatitur nga:
Fatlume Guri Selimi
Zyrtare e Lartë për Komunikim





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Data	11.12.24	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	109/02-31159
		Shtojcë	1.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, neni 68 pika 68.1, Statutit të Komunës, neni 10 pika 1 dhe 2 e Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për transparencë në komuna, Rregullores Komunale për Transparencë si dhe neni 17 të Udhëzimit Administrativ për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në bashkëpunim me Zyrën për Komunikim me Publikun organizojnë:

Takimin e dytë publik me qytetarë

Të enjten me datën 26.12.2024 duke filluar në orën 14:00.

Në këtë takim do të keni mundësi të njoftoheni për punën, të arriturat dhe sfidat e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2024, zhvillimet aktuale si dhe investimet kapitale, ndërsa pjesëmarrësit mund t'u shtrojnë pyetje dhe të japin propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për gjashtëmujorin e dytë dhe çështje tjera në interes të qytetarëve të komunës.

Të drejte pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Komunës së Kaçanikut.

Komentet dhe sygjerimet, mund t'i dërgoni deri me datën 26.12.2024 në ora 16:00. Email:

besim.q.ilazi@rks-gov.net, fatlume.selimi@rks-gov.net

Ftoheni për pjesëmarrje

Qytetarë të nderuar, bëhuni pjesë e proceseve vendimmarrëse në komunën tonë

Me respekt,

KRYETARI I KOMUNËS

Besim Ilazi

